



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA  
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Ministarstvo Kulture,  
Omaladine i Sporta /Ministry of Culture, Youth & Sports  
Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale  
Agencija za Upravljanje Memorialnih Kompleksa Kosova  
Agency on Management of Memorial of the Complexes of Kosovo



Komuna e Suharekës  
Opstine Suvareka  
Municipality of Suhareka

Në mbështetje të nenit 5 të Ligjit Nr.04/L-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-063 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosjen e Vijave Llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura, nenit 22 dhe 23 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 5 të Ligjit nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale si dhe Ligjit nr. 08/L-193 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2023, palët nënshkruese janë pajtuar për të nënshkruar këtë:

## MARRËVESHJE TË MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËFINANCIM

### PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “MUZEU I LIRISË” NË KOMUNËN E SUHAREKËS

Palët Nënshkruese:

Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale e përfaqësuar nga  
z. Bislim Zogaj, Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë

dhe

Komuna e Suharekës e përfaqësuar nga z. Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës

### Neni 1 Qëllimi

Kjo marrëveshje e mirëkuptimit nënshkruhet në mes të Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale dhe të Komunës së Suharekës, me qëllim të përcaktimit të obligimeve dhe përgjegjësisë të financimit të projektit të përbashkët me titull: “Muzeu i Lirisë”, në Komunën e Suharekës.

### Neni 2 Mënyra e bashkëfinancimit të projektit

1. Projekti “Muzeu i Lirisë” në Komunën e Suharekës, sipas planifikimit buxhetor ka koston financiare në total prej 70.000 (shtatëdhjetë mijë euro).

2. Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale financon këtë projekt në vlerën prej 50,000.00€ (pesëdhjetë mijë euro), nga projekti “Renovimi i Lapidarëve dhe Varrezave të Dëshmorëve në Komunën e Suharekës” me kod 18693 i paraparë në buxhetin e Agjencisë për vitin 2023.

3. Komuna e Suharekës financon këtë projekt në vlerën 20.000€ prej (njëzetmijë mijë euro), nga “Projektet me bashkëfinancim”, nga kodi 52616, i paraparë në buxhetin e Komunës së Suharekës, për vitin 2023.

### **Neni 3**

#### **Obligimet e Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale**

1. Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale, në pajtim me ligjin dhe këtë marrëveshje, zoton mjetet për projektin e paraparë në nenin 2 të kësaj marrëveshje dhe një kopje të zotimit e dërgon në Komunën e Suharekës për realizimin e projektit.

2. Pagesa për financimin e projektit “Muzeu i Lirisë” në Komunën e Suharekës, nga Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale do të ekzekutohet në pajtim me realizimin e projektit, sipas situacionit dhe raportit të Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës dhe Menaxherit të projektit të përcaktuar nga Komuna e Suharekës.

3. Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale mund të caktoj një zyrtar vëzhgues për përcjelljen e zbatimit të projektit “Muzeu i Lirisë” në Komunën e Suharekës, i cili do t’i raportojë Agjencisë.

### **Neni 4**

#### **Obligimet e Komunës**

1. Komuna e Suharekës obligohet që për projektin e “Muzeu i Lirisë” në Komunën e Suharekës, në pajtim me ligjin të zhvilloj procedurat që kanë të bëjnë me procesin e tenderimit, vlerësimit dhe dhënies së kontratës.

2. Komuna e Suharekës emëron Menaxherin dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, për realizimin e projektit si dhe për inspektimin e punimeve deri në përfundimin e projektit.

3. Komuna e Suharekës është e obliguar që të njoftoj Agjencinë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale për të gjithë hapat e realizimit të projektit.

### **Neni 5**

#### **Kohëzgjatja e marrëveshjes**

Marrëveshja e lidhur ndërmjet Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale dhe Komunës së Suharekës përfundon me realizimin e projektit.

**Neni 6**  
**Ndryshimet dhe ndërprerja e marrëveshjes**

1. Palët nënshkruese, zotohen se do t'i përmbahen kësaj marrëveshje bashkëfinancimi dhe në rast të kontestit eventual apo paqartësie për zbatimin e kësaj marrëveshje, pajtohen që përmes bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim të gjendet zgjidhje përkatëse, e në të kundërtën pajtohen që për zgjidhjen e kontestit t'i drejtohen gjykatës kompetente.
2. Për plotësimin dhe ndryshimin eventual të kësaj marrëveshje, palët nënshkruese pajtohen që të ndjekin rrugën e njëjtë si për nënshkrimin e marrëveshjes bazë.

**Neni 7**  
**Pronësia e projektit**


1. Me pranim-dorëzimin e punëve të kryera nga ana e operatorit ekonomik, ky projekt i paraparë sipas kësaj marrëveshje të mirëkuptimit, do të regjistrohet në pronësi të Komunës së Suharekës.
2. Ky projekt regjistrohet në pronësi të Komunës së Suharekës në mënyrë elektronike dhe fizike, në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).

**Neni 8**  
**Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi**

1. Kjo marrëveshje mirëkuptimi është hartuar në 4 (katër) ekzemplarë identik dhe secila palë nënshkruese merr nga dy ekzemplarë.
2. Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptimit fillon të zbatohet nga data e nënshkrimit të saj.

**PALËT NËNSHKRUESE TË MARRËVESHJES**

**Bislim ZOGAJ**

  
**Drejtore Ekzekutive**  
Agjencia për Menaxhimin  
e Monumenteve dhe  
Komplekseve Memoriale



**Bali MUHARREMAJ**

**Kryetar i Komunës**  
Komuna e Suharekës



Datë: 19.05.2023